

Procesverbal

Nga Mbledhja VIII (e tetë) e rregullt për vitin 2025 e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë: 26.09.2025

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e tetë të rregullt; dhe
3. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje kryetar, kolegë delegatë, OSBE, të pranishëm të tjerë! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen VIII të rregullt të KPF-së për vitin 2025. Materialin besoj se e keni pranuar të gjithë, ku i kemi tri pika të rendit të ditës dhe për seancë janë paraparë pesë pika të rendit të ditës dhe pika eventuale. Nëse keni diçka rreth rendit të ditës për KPF-në, mund ta merrni fjalën! Nëse jo, atëherë kush është për rendin e ditës të KPF-së? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Atëherë fillojmë te pika e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro miratimit të procesverbalit? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë pikën e parë. Atëherë fillojmë me materialin e seancës, pika e tretë: Anulimi i Vendimit për ndryshimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për parcelat P - 70604032-00348-0, 70604032-00348-2, 70604032-00348-3, 70604032-00346-0, 70604032-00347-0, Zona Kadastrale Plavë II, me kulturë bujqësore, ara të klasës së 3-të, me pronar Burim Piraj. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro këtij anulimi të Vendimit? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë te pika e katërt: Miratimi i Deklaratës Mbështetëse mbi Deklaratën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Dhunës Ndaj Grave në Politikë dhe Jetën Publike në Kosovë. A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë te pika e pestë: Propozimvendim për miratimin e Buxhetit të Komunës së Dragashit për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027 dhe 2028. A do dikush me e marrë fjalën për këtë pikë?

Munir Jonuzi: Përshëndetje të gjithëve. Në lidhje me miratimin e buxhetit vjetor për vitin 2026 kam vetëm dy pyetje dhe ato kanë të bëjnë me investimet kapitale. Më intereson çfarë është kjo nën numrin 2, fondi rezervë i komunës 200.000 euro, numri 2, fondi rezervë i komunës, dhe kemi 41 bashkëfinancime të projekteve me donatorë, ministrinë e zhvillimit rajonal dhe ministrinë e vetëqeverisjes lokale 180.500 euro. Për çfarë do të shpenzohen këto mjete nga numri 41? Faleminderit.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, zv/kryesues, të nderuar delegatë të Asamblesë Komunale, ju përshëndes dhe ju uroj punë të mbarë! I nderuar edhe përfaqësues i OSBE-së, një përshëndetje, çdo herë na keni përcjellë dhe keni qenë bashkë me ne! Sa u përket pyetjeve të z.Munir Jonuzi, 200 mijë euro janë mjete të cilat i kemi ndarë në fondin rezervë për pagesën e kontratës kolektive. Ndëra, ato mjetet për subfinancim edhe bashkëfinancim me donatorë, 90% e këtyre mjeteve do të shkojnë për pagesën e projektit të përbashkët Komunë-KEDS.

Artan Loshaj: Mirëmëngjesi për të gjithë! Kryetar, te Lista e shpenzimeve kapitale, para dy-tre muajve e kemi pas një listë tjetër, tash e kemi një listë tjetër. Po nisem te e para: Ndërtimi i deponive të ngurta Orqush dhe Rrenc keni pas të ndara 80 mijë euro. Me reagimin tin – nuk e di a keni bo me qëllim, veç për këtë vit në fushatë me i marrë votat, apo e keni largue definitivisht – për ndërtimin e deponisë në fshatin Rrenc. Po e due një përgjigje për këtë. E dyt, numër 4 ka qenë ndërtimi i kulmeve të ndërtesave në qytezën e Dragashit – 60 mijë euro. Tash, në këtë listën po e shoh 30 mijë euro. Çka është problemi, a është problemi pse unë kam kërkue për këtë edhe pse unë kam thënë e keni ulë, apo çka është puna. 10 ndërtesa, së paku secila ndërtesë i ka – mos ta teproj – mbi 20 metër katrorë. 10 ndërtesa me i ndreq me 30 mijë euro. M’u kon 10 shpia të Uzair Hamzës që po i ndreq në Gorë, apo të Halil Kastratit, nuk mundesh me i ndreq. Kjo është një përbuzje ndaj këtyre qytetarëve. Po kërkuj që së paku 100 mijë euro të jetë këtu. Ose, në qoftë se keni ndonjë plan 2-3 vjeçar, tregoni, se me 30 mijë euro, plus 20 mijë në qoftë se investon dikush, 10 kulme të ndërtesave të Dragashit. Kryetar, më lejo ta kryj, se unë jetoj në Dragash, ti veç vijsh e marrish pagën edhe shkojsh. Unë jetoj këtu. Unë? Sikur ti që je i Gorës, unë mundem me qenë edhe i Rrencit edhe i Dragashit. Me qenë i Rrencit është mirë, veç me qenë i Gorës është pak ma keq. Tash mos të hyjmë në personale. Unë të thashë 10 shpia Uzairi që po i ndreq nëpër Gorë, që po jau merr dokumentet, që po i rren për votat, këto shpiat nuk mundesh me i ndreq me 10 mijë euro. 10 kumeve të shtëpiave të Halil Kastratit nuk mundesh me i ndreq, e jo 10 kulme të ndërtesave të Dragashit. Me 30 mijë euro qekjo ndërtesa unë ku banoj edhe ku jetoj me 20 familje, nuk mundesh me i ndreq me 30 mijë euro. Për më shumë hollësi, të jap më 29-tin në seancë. Sot deshta veç me ta rikujtue. Unë nuk po them send, mirë po e bëjsh që po e bëjsh, ama problemi është që me 30 mijë euro nuk mundesh me e bo një kulm ti. Tjetra, në fshatin Rrenc, ku po të dhem, kryetar, i ke pas 68 mijë euro – ndërtimi i murit mbrojtës. Tash e ke qit 60 mijë euro. Ta kam thënë edhe ma herët, po ta them edhe tash, qat murin mbrojtës që e keni prish, që po doni me e ndreq te varrezat, edhe që po

doni me paret e fshatit Rrenc me e ndreq, e keni gabim, kryetar. Nuk bon me e bo këtë! Rrugën ku e keni ndreq me asfalt edhe që i keni prish varrezat, ato ndreqni me paret e Komunës, kryetar, jo me paret e taksapaguesve të fshatit Rrenc. Po shkojmë më poshtë, kur i ke nda paret për stadiumin – mirë ke bo që e ke ndreq stadiumin në Dragash, qato zhveshtoret, se kesh e i pashë, të përgëzoj se ke bo edhe punë të mira – se nuk e shoh veç zi unë Dragashin. Por, problemi është se ke ndarë për 2026-tën, 70 mijë euro për stadiumin e Blaçit. A po të kujtohet në 2022-tën kur di ndamë 50 mijë euro në mënyrë urgjente, çka u bo, 4 vjet pauzove, tash u kujtove në 2026-tën i ke shti edhe 70 mijë euro. Po e lëmë këtë edhe në eventuale, për deponinë kam qef me ma dhënë një përgjigje, edhe për qeto ndërtesat me 30 mijë euro, a mundesh me i ndreq a jo?

Munir Jonuzi: Kjo për bashkëfinancimin me KEDS -in, a nuk do të ishte më mirë të shkruajmë bashkëfinancim të projekteve me KEDS-in? T'i përcaktojmë këtu Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale dhe ta fusim edhe KEDS-in, pasi pjesa më e madhe e atij projekti lidhet me KEDS-in. Mendoj se kështu do të ishte më mirë, por ju jeni propozues i këtij buxheti dhe kjo është çështja juaj. Më tej, te investimet kapitale nën kodin 53, ndërtimi, rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit, rregullimi i infrastrukturës rrugore në rrugën Pod Ploça në fshatin Rapçë. Zoti kryetar, kryetari i Këshillit të Fshatit Rapçë ju ka dhënë emrin e projektit, ju ka dorëzuar kërkesën se si duhet të definohet ky projekt dhe sipas asaj kërkesë, ai thotë: ndërtimi i rezervuarit në vendin Pod Ploça (në kllapa), rehabilitimi ose renovimi i rrjetit të ujësjellësit në vendin Balabanopci, zgjerimi i ujësjellësit dhe shtrimi me kalldrëm i rrugëve në Rapçë. Kjo është e gjitha brenda një projekti. Nëse shohim kërkesën që ai ka paraqitur dhe nëse shohim këtë që është shkruar këtu, ka mjaft dallime. Duhet ta ndryshojmë emrin, pra të jetë ashtu siç ka kërkuar kryetari i fshatit Rapçë. Dhe më tej, këtu kemi 90 mijë, ndërsa në draftin e buxhetit kishim 95 mijë, prandaj më intereson pse 5 mijë më pak. A janë dëmtuar edhe fshatra të tjera si Rapça? Faleminderit.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro pikës së pestë? A ka kundër? Abstenim? Me 3 vota pro, 1 kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Atëherë, kalojmë te pika e tretë e KPF-së, pika eventuale. A do dikush me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Kryetar, pse bre në seancën e fundit nuk po bëhesh i sinqertë me m'i dhënë tri përgjigje, për deponinë, për murin mbrojtës edhe për ndërtimin e kulmeve. Nuk jam mo herën tjetër me ta lodh kryet. Seance e fundit, ma bën qefin, bare tash t'i marr do përgjigje. Edhe nuk deshta, për të madhin Zot po të bëj be – se Zotin ti e dish qysh e ke marak – nuk deshta me të përmend, po kur po ta përmendi Uzairin po të vjen shumë siklet. Çka është puna? Se kum marrë vesh unë që Uzairi ta ka bo – qetash kryetari i Komunës i ka dy nënshtetësi, e ka edhe një nënshtetësi bullgare ose boshnjake, s'po e kuptoj, se një foto e juaja po qarkullon nëpër Gorë në gjuhën boshnjake. Unë e di që një kryetar, Bexhet Xheladini, e ka një pasaportë të Kosovës, një letërnjoftim, edhe e ke doktor Bexhet Xheladini, shkruan në gjuhën shqipe, nëpër Gorë, në xhep e kam, e kam Bexhet Xheladini, s'e kuptova, a në gjuhën

boshnjake a në gjuhën bullgare, që po të reklamon Uzairi, ato fotot e zgjedhjeve. Emri yt nuk është Bexhet Xheladini në gjuhën shqipe. Sikur unë që lyp vota në Gorë edhe me e shkrua Artan Lošaj. Po ti e ke në gjuhën boshnjake ose bullgare, Uzairi që po i shpërndan, e ke në Gorë – unë e gjeta prom para Vivës letrën. Kryetar, po më vjen keq me ta ndërrue identitetin. Nëse i ke dy nënshtetësi, më kallxo. Këtë më 29-tin ta tregoj. Qaq siklet po të vjen prej Uzairit. Unë sa herë po i përmendi kulmet e Uzairit, po ty diqysh sikur me të prek në personale. Nuk po të kuptoj unë, kryetar. Një tradhtar që na ka tradhtue neve, ka me të tradhtue edhe ty me të 12-tin, se natën e fundit ai t’i ndërron lojërat. Maje në mend, më kap për fjalë, se Duda veç erdh me ne në Prizren. Prom e ke pa, zyrtarisht na ka lavdëruë jaranin e PDK-së. Uzairi deri më të 12-tin ta luan lijën, o kryetar, se 14 vjet na ka luftë edhe neve. Mos i beso bubit. Mos, po të them! Ty ta kanë ndërrue identitetin në Gorë. Ti nuk je Bexhet Xheladini, por je Bedz... s’po di, s’po di me e lexue. Kështu po më vjen keq për ty, se prapë jemi tonit na.

Munir Jonuzi: Emrat në gjuhën boshnjake shkruhen në origjinal, nuk ka “dž”, por shkruhen në formën origjinale. Do të thotë, nëse është gjuha boshnjake, atëherë përdoret “x” dhe “h” e jo “d” dhe “ž”. Kjo është në gjuhën serbe. Ndërsa mbishkrimi i poshtëm, ky tashmë është në boshnjakisht. Emri origjinal shkruhet në gjuhën boshnjake. Ndërsa në gjuhën serbe ai barazohet me gjuhën? A po kuptohemi? Ja, shiko kërkesat e mia. Në boshnjakisht dhe kroatisht, emrat shkruhen në origjinal, kur janë me alfabet latin. Në origjinal. Pra, në këtë rast, ashtu siç shkruhet emri i kryetarit në shqip, ashtu shkruhet edhe në boshnjakisht. Kjo është origjinale. Në gjuhën boshnjake dhe kroate. Ndërsa në gjuhën serbe, ai përshtatet me gjuhën serbe.

Artan Loshaj: Munir, sa të kuptova, domethënë në gjuhën boshnjake edhe kroate shkruhet si është emri i kryetarit. Unë e di që edhe në krejt botën, në krejt Evropën – i kam familjarët unë atje në Gjermani – Lochaj, Loshaj, edhe gjermani ia pranon këtë. Unë nuk po e di, po e kam në xhep, po s’po e qes – qe, kryetar – Dragaš, Bedzet, qeky emër s’po e di ku. Ti edhe në qoftë se bësh reklama duhet me e shkruë në gjuhën shqipe, ose veç nëse i ke dy nënshtetësi. Pa marrë parasysh qysh flet, gjuha boshnjake ose gorane, duhet me shkruë Bexhet. Unë veç të pyeta, është e juaja, unë të pyeta veç në qoftë se... jo jo, ti je kandidat për kryetar, nuk je Bexhet Xheladini këtu. Ti je kandidat, mos e merr personale. Na po folim për një kandidat që bon vaki kom me ardhë me ta ngue projektin kur ta kie dëgjimin në Rrenc, bon vaki edhe vi e të votoj unë. Jo, mu po më dhemb kjo. Nuk është personale kjo, unë nuk jam Artan Loshaj sot, unë jam kandidat për Asamble Komunale. Unë kam bo vota edhe në Brod, edhe në Bresanë kam bota. Jo, s’është personale kjo, personale kur të prekin në familje, ose në profesion. Në politikë nuk është personale kjo. Unë kam shkue, jam t’u lyp vota në Gorë, prej Restelicës e në Opojë deri në Zaplluxhe. Ti je kandidat për kryetar, nuk je Bexhet Xheladini këtu. Mu po më vjen keq me të shfrytëzue këtu qa poshtë edhe ulët Uzairi. Unë kam mendue se është bullgarisht – po mirë de, unë kam mendue, se nuk i kuptoj gjuhët. Kie me i pa fletushkat e mia në Gorë, unë ARTAN LOSHAJ. Ky e ka

Munir Jonuzi, edhe Munir Jonuzi e ka edhe në Dragash edhe në Restelicë. Mos e lë me luft me identitetin tënd Uzairin, se kanë me të tradhtue, o kryetar. Unë kam me të votue, Uzairi s'ka me të votue. Kupto, se më të 11-tin në aksham Duda ia ngreh Veshët, edhe kanë me të lënë. Është mirë me krejt me marrë vota, po je lëshue shumë në Gorë, se me Gorën dësh me fitue ti, kqyre pak edhe neve, se edhe na jemi votues tu. Kqyr kah na edhe pak. Kryekëput je lëshue te këta. Kanë me të tradhtue, kryetar, si neve . Mbaje në mend çka po të them, se kemi m'u takue kështu, se në Kuvend mo nuk më kie. Po i hupi zgjedhjet. Po më vjen keq, kryetar, për Zotin. Mos e bjer veten Uzair Hamza, se e di shumë mirë, nuk e kam personale, po ka luft shumë me ne. 14 vjet ka luft me ne edhe erdhe e mori topin, penall po e shuton te ti. Qeshtu me ty është t'u luft, edhe me krejt ne, se në emër tënd është t'u luft edhe me krejt ne, edhe më të 12-tin ka me e votue Shaban Shabanin kandidat për kryetar.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e mylli këtë takim të KPF-së, shihemi në seancë! Faleminderit!